

20252655101

МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА, ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ

Në bazë të nenit 167 paragrafi 2 të Ligjit të Mbrojtjes Sociale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 249/21, 99/22, 236/22, 65/23 dhe 192/25), Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve miratoi

R R E G U L L O R E

TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE TË PËRAFËRTA, DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM, FORMULARIT TË KËRKESËS PËR MARRJEN E LEJES SË PUNËS, MËNYRËS DHE PROCEDURËS PËR LËSHIMIN DHE REVOKIMIN E LEJES SË PUNËS DHE MËNYRËS SË MBAJTJES SË REGJISTRIMIT TË OFRUESVE TË LICENSUAR TË SHËRBIMEVE SOCIALE

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret e përafërta, dokumentacioni i kërkuar, formulari i kërkesës për marrjen e lejes së punës, mënyra dhe procedura për lëshimin dhe revokimin e lejes së punës, si dhe mënyra e mbajtjes së të dhënave të ofruesve të licencuar të shërbimeve sociale.

Neni 2

Institucioni i mbrojtjes sociale dhe ofruesi tjetër i shërbimeve sociale parashtron kërkesë për marrje të lejes së punës (në tekstin e mëtejshëm: kërkesa), në rast si i përmbush normat dhe standardet, kushtet, mënyrën dhe fushëveprimin e ofrimit të shërbimit social, të parashikuar për shërbimin konkret.

Kërkesa parashtrohet në Formular, të shtypur në letër të bardhë në formatin A4, i cili është bashkëngjitur dhe është pjesë përbërëse e kësaj Rregullore.

Personi fizik, kërkesën për kryerje të punëve të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale, e parashtron në Qendrën për Punë Sociale.

Neni 3

Institucioni i mbrojtjes sociale dhe ofruesi tjetër i shërbimeve sociale, ndaj kërkesës, parashtron:

- dëshmi se është organizatë juridikisht e themeluar, e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më e vjetër se gjashtë muaj nga dita e lëshimit, elaborat se i është siguruar hapësira, pajisjet dhe stafi profesional, në përputhje me normat dhe standardet për përmbushjen e kushteve për fillimin e punës dhe ofrimin e shërbimit konkret, si dhe masat e sigurisë në rast zjarri ose lloji tjetër të fatkeqësisë,

- program pune që përmban mënyrë të ofrimit të shërbimit social dhe të punës në mjedis jodiskriminues,

- plan vjetor të sigurimit të mjeteve financiare dhe materiale për ofrimin e shërbimeve sociale,

- procedura të brendshme të vlerësimit të shërbimeve të ofruara dhe të vlerësimit të kënaqësisë së përfituesve, në përputhje me normat dhe standardet për ofrimin e shërbimit.

Neni 4

Personi fizik ndaj kërkesës parashtron:

- dëshmi të përfundimit të arsimit të mesëm;
- vërtetim se aftësia e tij/saj afariste nuk i është revokuar ose kufizuar;
- vërtetim se nuk i është hequr e drejta e ushtrimit të së drejtës prindërore;
- dëshmi se ka aftësinë shëndetësore për kryerje të veprimtarisë dhe
- dëshmi se ka përfunduar trajnimin përkatës, në përputhje me standardet dhe normat e shërbimit konkret;
- vërtetim nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut se nuk është në marrëdhënie të rregullt pune.

Dokumentet personale të paragrafi 1 të këtij neni duhet bashkëngjitur në original ose si kopje, të vërtetuara nga noteri.

Personi fizik ndaj kërkesës i parashtron edhe dokumentet e nenit 3 paragrafi 1, alinetë 3, 4 dhe 5 të kësaj Rregullore.

Neni 5

Komisioni për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale, pas pranimit të kërkesës, verifikon nëse kërkesa është dorëzuar me dokumentacionin në përputhje me nenet 3 dhe 4 të kësaj Rregullore.

Nëse dokumentacioni ndaj kërkesës është i paplotë, Komisioni për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale do ta kontaktojë parashtruesin, që ta plotësojë të njëjtën brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit.

Nëse parashtruesi nuk vepron në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, kërkesa do të refuzohet.

Neni 6

Nëse kërkesa është e kompletuar, Komisioni për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale përcakton se a janë përmbushur kushtet për fillimin e punës dhe për ofrimin e shërbimit në bazë të:

- dokumentacionit të parashtruar,
- pas inspektimit të drejtpërdrejtë të parashtruesit të kërkesës, dhe
- vlerësimit të përmbushjes së normave dhe të standardeve për ofrimin e shërbimit social.

Nga ana e Komisionit për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale, në bazë të veprimeve të ndërmarra të paragrafit 1 të këtij neni, përpilohet mendim mbi përmbushjen e kushteve për kryerjen e punëve të mbrojtjes sociale.

Mendimi i paragrafit 2 të këtij neni nënshkruhet nga shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale.

Neni 7

Komisioni për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale kontrollon nëse ofruesi i shërbimit ofron shërbimin në përputhje me programin e punës dhe të lejes së punës.

Inspektimi i paragrafit 1 të këtij neni kryhet në përputhje me Rregulloren për Punë të Komisionit për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale.

Inspektimi i paragrafit 1 të këtij neni kryhet përmes inspektimit të Programit të Punës së Institucionit ose Ofruesit Tjetër të Shërbimeve, inspektimit të mënyrës dhe të kushteve për ofrimin e shërbimit dhe të raportit vjetor mbi zbatimin e programit të punës.

Në bazë të inspektimit të kryer të paragrafit 1 të këtij neni, nga ana e Komisionit për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale përcaktohet nëse institucioni ose ofruesi tjetër vazhdon t'i përmbushë kërkesat për ofrimin e shërbimeve sociale në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes Sociale dhe me këtë Rregullore.

Në rast se Komisioni për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale përcakton se institucioni ose ofruesi tjetër i shërbimeve sociale nuk i plotëson pjesërisht ose plotësisht kërkesat për ofrimin e shërbimit, përpilon mendim për kufizimin ose revokimin e lejes së punës së mbrojtjes sociale.

Mendimi i paragrafit 5 të këtij neni nënshkruhet nga shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale.

Neni 8

Kërkesa për ripërtëritjen e lejes së punës parashtrohet tre muaj para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së saj.

Neni 9

Komisioni për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale mund të ftojë përfaqësues të ofruesve publikë dhe privatë të shërbimeve sociale, dhe, në rast nevojë, edhe persona të tjerë profesionalë (arkitekt, inxhinier të ndërtimit), të jenë pjesëmarrës në mbledhjet e këtij Komisioni.

Neni 10

Në evidentimin e ofruesve të licencuar të shërbimeve sociale jepen të dhëna për

- emrin e institucionit të mbrojtjes sociale dhe ofruesit tjetër të shërbimeve sociale;
- të dhënat mbi personin udhëheqës të ofruesit të shërbimit;
- adresën e selisë së ofruesit të shërbimit, adresën elektronike dhe numrin e telefonit të kontaktit;
- llojin dhe fushëveprimin e shërbimit social, për të cilin është lëshuar leja për kryerje të punëve të mbrojtjes sociale;
- numrin e personave - ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimit;
- numrin dhe datën e aktvendimit të lejes së lëshuar për kryerjen e punëve të mbrojtjes sociale;
- periudhën për të cilën është lëshuar leja për kryerjen e punëve të mbrojtjes sociale, dhe
- numrin dhe datën e aktvendimit për kufizimin dhe revokimin e lejes për kryerjen e punëve të mbrojtjes sociale.

Evidentimi i paragrafit 1 të këtij neni mbahet i përditësuar në mënyrë elektronike nga Komisioni për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale.

Neni 11

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, pushon të vlejë Rregullorja e Kushteve dhe Kriteve të Përafërta, Dokumentacionit të Nevojshëm, Formularit të Kërkesë për Marrjen e Lejes për Kryerjen e Punëve të Mbrojtjes Sociale, Mënyrës dhe Procedurës për Lëshimin dhe Revokimin e Lejes për Kryerjen e Punëve të Mbrojtjes Sociale dhe Mënyrës së Mbajtjes së Evidencës së Ofruesve të Licencuar të Shërbimeve Sociale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 264/19).

Neni 12

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën pas publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 10-7833/3
26.12.2025
Shkup

Ministri i Politikës Sociale,
Demografisë dhe të Rinjve,
Fatmir Limani, d.v.

Shtojca

DREJTUAR:

MINISTRISË SË POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE TË RINJVE
Komisionit për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale

KËRKESË

për marrjen e lejes së punës së mbrojtjes sociale

Të dhënat e parashtruesit (të jepet emri i saktë)

||

Qëllimi i kërkesës (përshkrim i kërkesës konkrete)

||

Të dhënat e kontaktit (personi për kontakt, adresa elektronike, numri për kontakt)

||

Dokumentet e bashkëngjitura që dorëzohen (të përmenden)

||

(Dokumentet e dorëzuara të jenë të certifikuara në arkiv dhe të nënshkruara)

Parashtruesi i kërkesës,
